

Në bazë të nenit 25 paragrafit 1 të Vendimit mbi themelimin e trupave punuese të Kuvendit të Komunës ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 15/19), Kuvendit të Komunës së Tuzit i dorëzoj:

R A P O R T
nga seanca e VIII e Këshillit për Statut dhe RREGULLORE

Në seancën e mbajtur më 31.01.2020, prezent ishin: Fadil Kajoshaj – kryetar i Komunës, anëtarët Gjergj Camaj, Luigj Dedvukaj dhe Vasel Berishaj, ndërsa anëtarët Mirza Pepiq dhe Samra Gjokoviq nuk ishin të pranishëm.

Konstatohet kuorumi për punë dhe vendimmarrje të seancës. Pas kësaj, kalohet në përcaktimin e rëndit të ditës.

Nga ana e kryesuesit u propozua ky rënd dite:

- 1. Propozim i Vendimit mbi plotësimin e Statutit të Komunës së Tuzit.**
- 2. Propozim i Programit të rregullimit hapësinor i Komunës së Tuzit për vitin 2020.**
- 3. Programi i punës së SH.P.K. "Komunalno/Komunale" për vitin 2020. Me propozim-vendimin për dhënien e pëlqimit.**
- 4. Propozim i Vendimit mbi kompensimin për punë të trupave të përhershme dhe të përkohshme të Kuvendit të Komunës së Tuzit të themeluar me vendime të posaçme.**

Pas miratimit të rëndit të ditës, u kalua në shqyrtim dhe votim të pikave, ku nga pika 1 (e parë) deri te pika 4 (e katërt) të gjitha u votuan me nga 3 (tri) vota "PËR".

Anëtarët prezent të Këshillit për Statut dhe rregullore ishin të mendimit se propozimet e dorëzuara ishin në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe me rregulloret e tjera të vlefshme, më atë rast i propozohen Kuvendit të Komunës që të miratohen në seancë.

Për raportues të Këshillit në seancën e Kuvendit të Komunës së Tuzit e cila është caktuar më 31.01.2020 në orën 14.00 është vendosur që të jetë Fadil Kajoshaj, kryetar i Komunës.


KRYESUESI
Fadil Kajoshaj
